



Prishtinë: 24.06.2022  
Kodi i ZRRE-së: V\_1532\_2022

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_R\_2305\_05\_22**.

në seancën e mbajtur më datë 24.06.2022 nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **F.C.LLC** nga Komuna e Glllogocit si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi

### A r s y e t i m

**F.C.LLC** me datë 28.02.2022 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në Zyrën e Rregullatorit për Energji, duke kundërshtuar përgjigjen e KEDS-it – Divizioni i Pëlqimeve Elektroenergetike – Departamenti për Konsumatorë të datës 02.02.2022 për shkak të mos dhënies së pëlqimit për kyçje në rrjetin e KEDS në nivelin 35 kV.

Me datë 28.12.2021 konsumatori **F.C.LLC** ka bërë kërkesë zyrtare në KEDS për kyçje të tij në rrjetin e Shpërndarjes-KEDS në nivelin 35kV, përkatësisht në tri linjat e furnizimit me tension 35 kV: nga NS Drenasi-NS Feronikeli, NS Bardhi-NS Feronikeli dhe NS Parku i Biznesit-NS Feronikeli. Bazuar në kërkesën e konsumatorit vërehet se i njëjti ka bërë kërkesë për kyçje për kapacitet 2 MW ku konsumi do të shfrytëzohej për pajisjet kritike esenciale si pompat e drenazhës të vendosura nëpër objekte, panelet e elektronikës, automatike me PLC, SCADA si dhe për ndriçimin e objektit.

**Provë:** Kërkesa e konsumatorit datë 28.12.2021

Me datë 02.02.2022 Departamenti për Konsumator në KEDS i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar për kohësisht kërkesën e konsumatorit për kyçje në rrjetin 35 kV bazuar në pamundësinë teknike të kyçjes - përkatësisht mungesës së rrjetit 35 kV në pronësi të tij dhe stabilimenteve shpërndarëse / distributive përmes së cilave do të furnizonte konsumatorin.

**Provë:** Përgjigja e KEDS-it e datës 02.02.2022

Me datë 24.02.2022 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KEDS si dhe ka kërkuar të mundësohet ri kyçja në linjën ekzistuese në nivelin e tensionit 35 kV.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 24.02.2022



Bordi i ZRRE-së duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEDS/KECO, ka vërejtur se:

Me datë 28.12.2021 konsumatori **F.C.LLC** ka bere kërkesë zyrtare në KEDS per kyç jen e tij ne rrjetin e Shpërndarjes-KEDS ne nivelin **35kV**, përkatësisht ka propozuar mundësin e kyçjes se objektit te tyre ne tri linjat e furnizimit me tension **35 kV**: nga **NST Drenasi-NST Feronikeli**, **NST Bardhi-NST Feronikeli** dhe **NST Parku i Biznesit-NST Feronikeli**. Aplikuesi **NEWCO Feronikeli Complex LLC** se bashku me kërkesën per kyçje per tri opcionet apo mundësit e propozuar për kyçje ka bashkëngjitur edhe gjendjen gjeografike te shtrirjeve te këtyre linjave. Bazuar ne kërkesën e konsumatorit vërehet se i njëjti ka bere kërkesë per kyçje per kapacitet 2 MVA ku konsumi do te shfrytëzohej per pajisjet kritike esenciale si: pompat e drenazhës te vendosura neper objekte, panelet e elektronikes, automatike me PLC, SCADA si dhe per ndriçimin e objektit.

Me datë 02.02.2022 Departamenti për Konsumator në KEDS i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar përkohësisht kërkesën e konsumatorit per kyçje ne rrjetin 35 kV bazuar ne pamundësinë teknike te kyçje s - përkatësisht mungesës se rrjetit 35 kV si dhe stabilimenteve distributive. Ne përgjigjen e lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes-KEDS theksohet se: pas daljes dhe inspektimit ne teren si dhe shtrirjes gjeografike te rrjetit te KEDS-it është konstatuar se objekti i juaj veç se furnizohet nga një pike tjetër nga niveli 220 kV. Duke u thirrur ne kërkesën e konsumatorit per siguri ne furnizim KEDS ka informuar konsumatorin se KEDS asnjëherë nuk ka dhënë leje per kyçje nga dy linja per te njëjtën pronë/kompani/objekt e aq me tepër ne nivele te ndryshme te kyçjes dhe se nuk ka rregullim ligjor per shqyrtimin e tyre. Ne vazhdimësi te përgjigjes, KEDS ka arsyetuar se ne afërsi te konsumatorit nuk ka ne dispozicion apo ne pronësi rrjet te nivelit te tensionit 35 kV, pasi që nënstacioni i cili ka ekzistuar me herët ne këtë pjese e i cili per një kohe te gjatë ka qenë i kyçur nga NS i juaj tani me nuk ekziston pasi qe i gjithë rrjeti i tensionit te mesëm është transferuar ne **10/20 kV** me transformim nga 220 kV nga operatori i transmisionit KOSTT. KEDS ne përgjigje thekson po ashtu se duke pasur parasysh se konsumatori furnizohet përmes linjës se KOSTT 220 kV, çfarëdo lidhje tjetër alternative per furnizim me energji elektrike bie ne kundërshtim me Kodin e Rrjetit duke pasur parasysh se i njëjti objekt nuk mund te furnizohet nga dy kyçje alternative per shkaqe te sigurisë së rrjetit te shpërndarjes dhe operimit te punëtorëve ne teren. KEDS po ashtu ka theksuar se kyçja ne linjën 35 kV e cila vjen direkt nga KEK e qe është ne pronësi te KEK-ut edhe nëse do te aprovohej nga KEDS do te duhej qe paraprakisht te merrte një aprovim nga KEK si pronare e linjës. Po ashtu është theksuar se kyçja ne këtë linje ne aspektin teknik do te përkeqësonte furnizimin e konsumatorëve ekzistues ku potencialisht do te ndikonte edhe ne rënien e tensionit per shkak te ngarkesës, distancës se largët, dimensionit te linjës si dhe gjendjes aktuale te saj. Po ashtu konsumatori është njoftuar se kjo linje 35 kV pritet qe te eliminohet tërësisht nga përdorimi.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes përgjigjen e KEDS-it per konsumatorin **F.C.LLC** lidhur me kërkesën per kyçje ne rrjetin 35 kV, dhe konstaton se bazuar ne te dhënat e evidentuara ne përgjigje, konsumatori **F.C.LLC** është i kyçur ne nivelin e Tensionit te Lartë **220 kV** bazuar edhe ne kapacitetin instalues/kërkesës se tij, prej nga edhe behet furnizimi dhe matja e shpenzimeve energji elektrike, si dhe ka marrëveshjen e kyçje s së nënshkruar me KOSTT. Po ashtu KEDS ka dëshmuar se nuk ka kushte teknike per furnizim pasi qe nënstacioni i cili ka ekzistuar ne këtë pjese e i cili per një kohe te gjatë ka qenë i kyçur nga NS **F.C.LLC** tani me nuk ekziston pasi qe i gjithë rrjeti



i tensionit te mesëm është transferuar ne 10/20 kV me transformim nga 220 kV nga operatori i transmisionit KOSTT, kurse linja per te cilën konsumatori ka bere kërkesë per kyçje është pronë e KEK.

Refuzimi i qasjes së palës së tretë ne rrjetin e Shpërndarjes apo edhe te Transmisionit mund te behet vetëm ne rastet kur nuk ka mundësi teknike te kyçje s dhe kjo është e rregulluar me Ligjin per Energjinë elektrike (Ligj.NR.5/L-085) neni 45 përkatësisht paragrafi 1 e ku thuhet se: **“Operatori i Sistemit të Transmetimit apo Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të refuzojnë qasjen në sistemin e transmetimit apo të shpërndarjes nëse nuk ka në dispozicion kapacitete të nevojshme, dhe nëse mungesa e kapaciteteve arsyetohet në mënyrë objektive në bazë të kriterëve të arsyeshme teknike, duke pasur parasysh sigurinë e furnizimit, ose cilësisë së furnizimit, duke marrë parasysh standardet e shërbimit dhe besueshmërinë e kërkuar nga personi që kërkon qasje, si dhe të gjitha kodet dhe rregullat në fuqi”**, kurse neni 51 paragrafi 4 i këtij ligji përcakton rastet kur operatori i sistemit mund ta refuzojë përkohësisht kyçjen e një aplikuesi e ku thuhet se: **“Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund ta refuzojë përkohësisht kyçjen e një konsumatori ose prodhuesi në sistem, nëse konstaton se pajisjet e konsumatorit apo të prodhuesit nuk plotësojnë normat teknike ose kushtet tjera të përshkruara në Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Kodin e rrjetit të shpërndarjes”**.

Po ashtu ne nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 te Rregullës per Kushtet e Përgjithshme te Furnizimit me Energji elektrike është e rregulluar e drejta e konsumatorëve per kyçje, e ku thuhet se: **“Të gjithë konsumatorët kanë të drejtën që të kërkojnë kyçje të objekteve dhe pajisjeve të tyre energjetike në rrjetin e operatorit të sistemit, nëse një kyçje e tillë është teknikisht e mundur, sipas dispozitave të Kodit të Rrjetit ose Shpërndarjes, ndonjë kodi ose Rregulle tjetër në fuqi”**.

Kurse neni 10 paragrafi 1 dhe 3 i Rregullës per Kushtet e Përgjithshme te Furnizimit me Energji elektrike përcakton rastet kur operatori i sistemit mund ta refuzojë përkohësisht kyçjen e një aplikuesi e ku thuhet se: **1. “Operatori i Sistemit mund të refuzoj të kyç një aplikues përkohësisht, vetëm nëse ajo kyçje nuk është në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit dhe Shpërndarjes ose kodeve tjera në fuqi”, dhe 3. “Operatori i sistemit do të refuzoj të kyç një aplikues në rast se nuk ka kapacitetet të mjaftueshëm të rrjetit, por nuk do të refuzojë një kyçje për një aplikues mbi bazën që nuk ka gjenerim të mjaftueshëm të lidhur me rrjetin”**.

Ligjet primare të sektorit te energjisë, kodet teknike si dhe rregullat e nxjerra nga ZRRE nuk e përcaktojnë si mundësi furnizimin alternativ te konsumatorit te njëjtë ne dy nivele te ndryshme tensioni, pra te gjithë konsumatorët kanë një numër unik identifikues e te cilët furnizohen nga një operatore i vetëm sistemit, transmisionit apo edhe shpërndarjes me te cilët duhet te ketë edhe marrëveshje te kyçjes e qe ne rastin e konsumatorit **F.C.LLC** i njëjti ka marrëveshje te nënshkruar me KOSTT me datë 08.04.2020 ku është e definuar se: Pika e kyçje s per Feronikelin SH.p.k me kapacitet te kyçje s prej 2x160 MVA, është ne nivelin e tensionit 220 kV, përkatësisht ne linjat ekzistuese 220 kV LP 208 dhe linja 220 kV LP 209.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.06.2022 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nixirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Ymer Fejzullahu, Kryesues

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

---

Lutfije Dervishi, anëtare

---

Gani Buçaj, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Konsumatorit: **F.C.LLC**
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.